



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E BRENDSHMË
DREKTORIA E PËRGJITHSHMË POLICISË SË KËTËTIT
AKADEMIA E SIGURISË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 14 Prot.

Tiranë më, 04.04.2022

V E N D I M

Nr. 07, datë 04.04.2022

Për përzgjedhjen e kandidateve dhe procedurave të punësimit të Administratorit të Akademisë së Sigurisë.

Bordi i Administrimit, në mbledhjen e tij të datës 04.04.2022, bazuar në nenin 49 pika f) të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë";

V E N D O S I:

KRITERET E KANDIDATIT PËR ADMINISTRATOR NË AKADEMINË E SIGURISË JANË SI MË POSHTË:

KRITERE TË PËRGJITHSHME:

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të jetë i aftë nga ana shëndetësore;
4. Të ketë formim universitar, së paku në nivelin "Master i shkencave", në fushën e ekonomisë ose drejtësisë dhe së paku shtatë vjet punë në këto fusha;
5. Të mos ketë papajtueshmëri në kuptim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike";
6. Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze;
7. Të mos jetë i dënues me vendim gjykatë të formës së prerë për kryerjen e ndonjë krimi apo për kryerjen e një kundërvajtje penale me dashje.

KRITERE TË VEÇANTA:

1. Të ketë përvojë pune në hartimin e buxhetëve dhe menaxhimin e fondeve;
2. Të ketë përfunduar studimet Bachelor dhe "Master i shkencave", në fushat e përcaktuara;
3. Të ketë eksperiencë drejtuese në nivele të larta në administratën publike ose në sektorin privat.

4. Të mos jenë marrë ndaj tij masa disiplinore të largimit ose e përjashtimit nga administrata shpërndarë, e cila nuk është shuar;
5. Të ketë vlerësim punë "mirë" ose "shumë mirë", për tre vitet e fundit.

PËRSIKURIMI PËRCAKTUESHËS I FUNËS PËR POZICIONIN ADMINISTRATIV I AS:

1. Bashkërendon, mbikëqyr dhe menaxhon strukturën e financës, të sektorit ekonomik e shërbimeve, si dhe të sektorit të disiplinës dhe sigurisë, në varësi funksionale të tij;
2. Ndjek, kontrollon dhe përgjigjet për zbatimin e buxhetit vjetor të AS, sipas legjislativimit në fuqi dhe për shpenzimet buxhetore të akorduara për institucionin;
3. Planon projektbuxhetin vjetor mbi bazën e propozimeve të njëjtit kryesor dhe njëjtit bazë, mbështetur në planin strategjik të zhvillimit të AS dhe në planin buxhetor afatmesëm të tij;
4. Koordinon veprimtarinë e sektorëve në varësi, për të patur në funksionim të plotë të gjithë infrastrukturën e duhur dhe burimet financiare, ku mbështetet veprimtaria e institucionit;
5. Zbaton vendimet me karakter financiar dhe administrativ të Bordit të Administrimit dhe të Senatit Akademik;
6. Propozon kritere për administrimin e burimeve financiare dhe materiale, të cilat ia kalon për miratim Bordit të Administrimit, mbikëqyr shpërndarjen dhe zbatimin e tyre;
7. I paraqet Bordit të Administrimit dhe Senatit Akademik raportin mbi veprimtarinë financiare të AS, në përfundim të vitit akademik;
8. Raporton për veprimtarinë e tij në Bordin e Administrimit dhe Senatit Akademik, në lidhje me aspektin financiar, ekonomik, shërbime, disiplinë dhe sigurinë, sipas përcaktimeve në aktet ligjore, nënligjore dhe Statutin e Akademisë së Shqipërisë;
9. Plotëson kërkesat e Rektorit me qëllim përmbushjen e nevojave akademike, administrative dhe financiare.

KANDIDATËT KONKURENTË PËR ADMINISTRATOR NË AKADEMINË E SIGURISË DO TË PARAQESIN KËTO DOKUMENTE:

1. Kërkesë të motivuar, ku paraqiten arsyet e aplikimit në këtë funksion;
2. Letëshkrimin (CV) sipas formatit standard (europass);
3. Dokument identifikimi;
4. Kopje të notizuar e diplomës/diplomave dhe/ose njehsimin e tyre në "Masier i Shkencave", (për diplomat e marra jashtë vendit);
5. Kopje të libërës së punës;
6. Vërtetim i gjendjes gjyqësore (dëshmi penalistik);
7. Vërtetim të gjendjes shtetëtare;
8. Vërdëklarim që nuk gjendet në kushtet e konfliktit të interesit për pozicionin e punës "Administrator i AS-së" për të cilin kandidon;
9. Deklaratë individuale që kandidati nuk ka papajteshmëri sipas ligjit nr. 138/2015 "Për garanzimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike";
10. Dëshmi e zotërimit të gjuhës së huaj angleze, në nivelin jo më të ulët se B2, sipas certifikatave ndërkombëtare të njohura nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
11. Letrat e referencës nga punëdhënësit e mëparshëm, të cilat provojnë vlerësimet pozitive në punë dhe që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
12. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet, arimin ehoet, të cilat mund të shërbejnë për verifikimin e kritereve preferencialë;
13. Të dorëzojë prezantimin të primuar pranë Bordit të Administrimit të AS, pasi është miratuar lista përfundimtare e kandidatëve nga Senati Akademik i AS, të paktën 3 ditë pune përpara datës së intervistës, në adresën: Bordi i Administrimit, Akademia e Sigurisë, Sullt Tirand.

Mungesa e një prej dokumenteve të kërkuara më sipër, njësi shkallëkon të kandidatit.

Dokumentacioni i dorëzuar, nuk i kthehet kandidatit, por bëhet pjesë e arkivës në Institucionit.

DORËZIMI I DOKUMENTEVE:

1. Kandidatët e interesuar duhet të paraqesin dokumentacionin e kërkuar brenda 2 (dy) javësh nga e nesërmeja e shpalljes së njoftimit në Buletinin e Agjencisë së Prokurimit Publik, në adresën: www.app.gov.al;
2. Dokumentet dorëzohen në Senatin e Akademisë së Sigurisë, pranë Rektoratit të AS;
3. Dokumentacioni i kërkuar dorëzohet dorazi nga kandidati ose në rrugë postare në adresën: Akademia e Sigurisë, Saut, Tiranë, "Applikim për pozicionin e punës: Administrator i Akademisë së Sigurisë";
4. Nuk pranohet dokumentacion pas datës së caktuar.
5. Procedurat e konkurimit do të zhvillohen në ambientet e Akademisë së Sigurisë, Saut Tiranë.

INTERVISTIMI NGA BORDI I ADMINISTRIMIT, KU DUHET TË DEMOSTROHEN:

1. Njohuri të legjislacionit sektorial në fushën e arsimit të lartë;
2. Njohuri për ligjin "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe ligjin "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë";
3. Njohuri të sistemit të arsimit të lartë;
4. Afësi të mira prezantuese, komunikuese dhe të punës në grup;
5. Afësi për të paraqitur një plan konceptual për mënyrën se si do të realizojnë drejtimin dhe administrimin në AS;
6. Prezantimi i planit konceptual do të jetë me Power Point, deri në 10 minuta.

PUBLIKIMI I NJOFTIMIT:

1. Pas miratimit të kriterave dhe procedurave për zgjedhjen e administratorit të AS-së nga Bordi i Administrimit, dërgohet njoftimi për shpallje në Agjencinë e Prokurimit Publik (APP) (shkresë zyrtare dhe me CD);
2. Bordi i Administrimit njofton Senatin Akademik për kriteret dhe procedurat e miratuara, si dhe e njofton për shpalljen e dërguar në APP;
3. Ngarkohen strukturat përkatëse në Rektorat të publikojnë njoftimin në faqen zyrtare të AS-së dhe të organizojnë marrjen në dorëzim të dokumentacionit nga konkurrentët dhe përfaqësimin e tyre në Senatin Akademik;
4. Senati Akademik sipas ligjit nr. 80/2015, neni 51, pikë 2, mirëton listën e kandidatëve që plotësojnë kriteret e përgjithshme të miratuara dhe të shpallura nga Bordi Administrimit brenda 7 (shtatë) ditëve kalendarike nga përfundimi i afatit të dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët;
5. Bordi i Administrimit organizon procesin e intervistimit të kandidatëve, brenda 7 (shtatë) ditëve kalendarikenga miratimi i listës së kandidatëve që plotësojnë kriteret e përgjithshme nga Senati Akademik.
6. Kandidatët konkurrentë për Administrator në Akademinë e Sigurisë, do të vlerësohen sipas pikezimit. Sistemi i vlerësimit është i përbërë prej 100 pikësh, të ndara në:
 - a. kriteret e përgjithshme të cilat vlerësohen deri në 30 pikë;
 - b. kriteret e veçanta të cilat vlerësohen deri në 30 pikë;
 - c. procesi i intervistës e cila vlerësohet deri në 40 pikë.

7. Bordi i Administrimit në Akademinë e Sigurisë zgjedh kandidaturën fituese për problemin e punës Administrator i AS-së me shumicë votash.
8. Kandidatët konkurues do të njohohen elektronikisht për rezultatet paraprake të konkurrimit, orën dhe datën e intervistës dhe për shpalljen Ajoftimi i Fituesit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT I AKADEMINË SË SIGURISË


KRYETARI

Albert ~~FERMISHAJ~~




ANËTARI

~~Eda GJOKA~~



Eda GJOKA



~~Kenan VOCAJ~~

Neritan NALLBATI



Arjan ZOKO



Iva HOKHA

